



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:914066  
Datë: 30.09.2021  
Numri i dokumentit: 02231649

Ac.nr.1188/19

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli - kryetare e kolegjit, Gani Avdiu dhe Faton Ademi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.K. nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Avokatja Publike Komunale Fatime Mustafa, me objekt kontesti kompensimin e pagave për përcjellje në pension, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësueses së autorizuar të të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.391/17, të datës 18.01.2019, në seancën jo publike të kolegjit, të mbajtur me datë 28.09.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.391/17, i datës 18.01.2019, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.391/17, të datës 18.01.2019, e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit I.K. nga fshati ..., Komuna e Lipjanit dhe e ka detyruar të paditurën Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësit, me rastin e pensionimit në emër të shpërblimit të 3 pagave përcjellëse t'ia paguajë shumën prej 1,376,91 Euro, me kamatë vjetore prej 8%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë me dt.10.06.2017 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 165.00 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit të paraparë ligjor, ankesë ka parashtruar e autorizuar e të paditurës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata

e Apelit ta aprovojë ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta anulojë dhe çështjen ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

*-Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.*

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi I.K. nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, me dt.24.08.2017 pranë gjykatës së shkallës së parë ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimin e pagave për përcjellje në pension dhe shpërblim jubilar. Në padinë e precizuar ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensojë pagat përcjellëse në lartësi prej 1,376,91 Euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke u llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm. Po ashtu, i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.391/17, të datës 18.01.2019, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: nga provat e administruara nuk është kontestues fakti që paditësi ka qenë në marrdhënie pune tek e paditura, fakt ky që vërtetohet nga vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Skenderbeu" në fshatin Kraishtë, me nr.564/VI, dt.06.04.2017, vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Ibrahim Banushi" në fshatin Shalë, nr.2/615, dt.14.04.2017, vërtetimi mbi përvojën e punës i lëshuar nga SHFMU "Idriz Ajeti" në fshatin Pjetershtivë si dhe vërtetimi i lëshuar nga SHFMU "Kadri Beka" në fshatin ..., nr.834, i dt.10.05.2017, nga të cilat prova vërtetohet se paditësi ka punuar tek e paditura në kohëzgjatje prej më shumë se 30 vjet. Më tutje është konstatuar se paditësi me dt.22.05.2017 i është drejtuar të paditurës me kërkesë për kompensimin e pagave përcjellëse, mirëpo e paditura nuk i është përgjigjur një kërkesë të tillë, andaj paditësi i është drejtuar gjykatës me padi. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se paditësi ka të drejtë në shpërblim të tri pagave përcjellëse, e drejtë kjo e cila i takon në kuptim të dispozitës së nenit 35 par.9 të Kontratës Kolektive të Arsimit, e cila parasheh që punëtorët e SBASHK-ut që dalin në pension fitojnë pagesë përcjellëse në lartësi prej tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorëve. Lartësinë e pagës, gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në regjistrin e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për dt.01.02.2017, 01.03.2017 dhe 01.04.2017, nga i cili ka vërtetuar se paditësi nga e paditura ka realizuar pagë neto prej 458,97 euro. Obligimin e të paditurës që paditësit t'ia kompensojë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka arsyetuar në këtë mënyrë: në emër të përfaqësimit të autorizuarit të paditësit në shumë prej 135,00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore për padi në shumë prej 30,00 euro.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të përfaqësueses së autorizuar të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, nuk është kontestuese në mes palëve se paditësi ka qenë në marrdhënie pune tek e paditura, fakt ky që provohet nga vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Skenderbeu” në fshatin Kraishtë, me nr.564/VI, dt.06.04.2017, vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Ibrahim Banushi” në fshatin Shalë, nr.2/615, dt.14.04.2017, vërtetimi mbi përvojën e punës i lëshuar nga SHFMU “Idriz Ajeti” në fshatin Pjetershtivë si dhe vërtetimi i lëshuar nga SHFMU “Kadri Beka” në fshatin ..., nr.834, i dt.10.05.2017, nga të cilat prova vërtetohet se paditësi ka punuar tek e paditrua në kohëzgjatje prej më shumë se 30 vjet.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se:

Me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve*”. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b) nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes*”. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës*”. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...*”.

Me nenin 35 paragraf 9, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 përcaktohet se: “*Punëtorët (anëtarë të SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë pagesë përcjellëse në lartësi të tri pagave sipas mesatares së tri pagave të fundit të punëtorit, 9.1. Pagat përcjellëse paguhen nga punëdhënësi i fundit dhe jo më larg se 30 ditë, nga dita e pensionit*”.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që paditësit, me rastin e pensionimit në emër të shpërblimit të 3 pagave përcjellëse t’ia paguajë shumën prej 1,376,91 Euro, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017, ndërsa paditësi ka dalë në pension më datë 09.05.2017, çka do të thotë se kjo marrëveshje - kontratë ka qenë në fuqi në momentin e pensionimit dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës dhe se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar. Lartësia e kërkesëpadisë është e mbështetur në regjistrin e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për dt.01.02.2017, 01.03.2017 dhe 01.04.2017, nga i cili ka vërtetuar se paditësi nga e paditura ka realizuar pagë neto prej 458,97 euro.

Vendimi sa i përket kamatës nga gjykata e shkallës së parë, është në përputhje të plotë me dispozitën nga neni 382 paragrafi 1 dhe 2 i LMD-së, Ligji 04/L-077 i datës 30.05.2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20.12.2012.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat nga nenet 449, 452 lidhur me nenin 463 të LPK-së, ndërsa lartësia e tyre i referohet veprimeve të ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe atë: në emër të përfaqësimit në një seancë gjyqësore në shumë prej 135,00 Euro si dhe në emër të taksës për padi në shumë prej 30,00 Euro të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 165,00 Euro.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ac.nr.1188/19, me datë 28.09.2021

Kryetare e kolegjit,  
Hunaida Pasuli